

VENDIM
Nr. 77, datë 28.1.2015

**PËR KONTRIBUTET E DETYRUESHME DHE PËRFITIMET NGA SISTEMI I
SIGURIMEVE SHOQËROREDHE SIGURIMI I KUJDESIT SHËNDETËSOR**

*(Ndryshuar me VKM nr. 653, datë 22.7.2015; nr. 551, datë 27.7.2016; nr. 660, datë 10.10.2019; nr. 720,
datë 16.9.2020; nr. 702, datë 13.11.2024)*

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr.10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ligjit nr.10139, datë 15.5.2009, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”, të ligjit nr.150/2014, “Për pensionet e punonjësve të nëntokës” dhe të ligjit nr.9136, datë 1.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. KATEGORITË E PERSONAVE TË MBROJTUR DHE TË DETYRUAR PËR T’U SIGURUAR, SIPAS DEGËVE E SKEMAVE TË SIGURIMIT

Konsiderohen të mbrojtur dhe përfitojnë të ardhura e shërbime nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë:

1. Personat që zhvillojnë aktivitet ekonomik dhe kanë plotësuar moshën e punës, sipas përcaktimeve në Kodin e Punës, si më poshtë vijon:

a) Të punësuarit me mandat kushtetues, të punësuarit e emëruar, të punësuarit me kontratë pune pa afat ose me afat më shumë se një muaj, që punojnë me kohë të plotë ose të pjesshme, për 87 (tetëdhjetë e shtatë) orë në muaj e më shumë, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme, por jo më pak se niveli minimal, për degën e sigurimit të sëmundjeve, të barrë lindjes, të pensioneve, të aksidenteve në punë e sëmundjeve profesionale, të papunësisë dhe për sigurimin e kujdesit shën-detësor;

b) Të punësuarit me kontratë pune me ose pa afat, që punojnë me kohë të pjesshme, që zgjat më pak se 87 (tetëdhjetë e shtatë) orë në muaj, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme, por jo më pak se niveli minimal, për degën e barrë lindjes, pensioneve, aksidenteve në punë e sëmundjeve profesionale dhe për sigurimin e kujdesit shëndetësor;

c) Të punësuarit me kontratë pune, me kohë të plotë ose të pjesshme ditore, që zgjat më pak se 7 (shtatë) ditë kalendarike radhazi në vit, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme për degën e aksidenteve në punë e sëmundjeve profesionale dhe për sigurimin e kujdesit shëndetësor;

ç) Pronarët e personave juridikë, që ushtrojnë funksione drejtuese në shoqëri, si administratorë apo çdo funksion tjetër, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme, sipas përcaktimeve në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1, të këtij vendimi;

d) Të vetëpunësuarit me statusin e personit fizik, që ushtrojnë veprimtari ekonomike, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme, jo më pak se niveli minimal, për degën e barrë lindjes, pensioneve dhe për sigurimin e kujdesit shëndetësor;

dh) Pjesëtarët e familjes, që punojnë e bashkëjetojnë ligjërisht me të vetëpunësuarin, person fizik, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme, jo më pak se niveli minimal, për degën e barrë lindjes, pensioneve dhe për sigurimin e kujdesit shëndetësor;

e) Personat e vetëpunësuar si shtës ambulantë, sipas përkufizimit të dhënë në shkronjën “j”, të nenit 5, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme për degën e pensioneve dhe për sigurimin e kujdesit shëndetësor.

ë) Personat e punësuar, që punojnë me kohë të plotë apo të pjesshme pune, si punëtorë shtëpie në familjet e të tjerëve, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme për degën e pensioneve dhe për sigurimin e kujdesit shëndetësor. Konsiderohen “punëtorë shtëpie” personat që punësohen nga kryefamiljari, në punë të tilla si, kujdestar për fëmijët, kuzhinier, pastrues, roje-administrator shtëpie, asistent për të moshuarit, etj., apo edhe shërbime të ndryshme të kësaj natyre;

f) Nxënësit e shkollave të mesme apo profesionale, si edhe studentët, për kohën e programuar të praktikës mësimore dhe praktikave profesionale pa pagesë, për të cilët paguhen kontribute nga punëdhënësi, në nivelin minimal, vetëm për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, për aq kohë sa është përcaktuar në kontratën e lidhur ndërmjet subjektit dhe institucionit përgjegjës;

g) Personat e punësuar për herë të parë, në subjekte të cilat zhvillojnë aktivitete ekonomike sipas Regjimit të Përpunimit Aktiv (fason), për një periudhë deri në tre muaj të formimit profesional, për një profesion të caktuar, të kualifikuar, që sigurohen në mënyrë të detyrueshme, në nivel minimal, vetëm në degën e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, me kushtin që subjekti punëdhënës nuk përfiton financime nga programet e nxitjes së punësimit nëpërmjet formimit profesional;

gj) Personat e punësuar në dy ose më shumë subjekte juridike ose fizike, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme, për degën e sigurimit të sëmundjeve, barrë lindjes, pensioneve, aksidenteve në punë e sëmundjeve profesionale, papunësisë dhe për sigurimin e kujdesit shëndetësor;

h) Personi fizik që, njëkohësisht, zhvillon aktivitet ekonomik si anëtar i papaguar i familjes, si edhe anëtar i papaguar i familjes, që zhvillon aktivitet ekonomik në dy persona fizikë, me të cilët bashkëjeton, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme për degën e sigurimit të barrë lindjeve dhe pensioneve dhe për sigurimet e kujdesit shëndetësor;

i) Personat e punësuar për më shumë se 87 orë në muaj, në rast sëmundjeje ose kujdesjes për fëmijën në ngarkim, të vërtetuara me raport mjekësor për deri në 14 ditët e para, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme. Përlllogaritja e kontributeve të sigurimeve shoqërore, të sigurimit të kujdesit shëndetësor, si dhe tatimi mbi të ardhurat nga punësimi, zbatohet njëjloj, ashtu si për të ardhurat nga puna, pavarësisht se mënyra e llogaritjes së tyre i referohet dispozitave të veçanta të Kodit të Punës;

j) Të vetëpunësuarit në bujqësi, të aftë për punë, që kanë mbushur moshën 16 vjeç, deri në moshën për pension, sipas nenit 92, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kur:

i) nuk janë të siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë, banojnë në të njëjtën rreth ku kanë tokën në pronësi ose në përdorim dhe zhvillojnë veprimtari bujqësore e blegtorale, që paguajnë kontribute në mënyrë të detyrueshme për barrë lindje, për pensione dhe për sigurimin e kujdesit shëndetësor;

ii) nuk janë të siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë, banojnë në fshat dhe zhvillojnë veprimtari bujqësore e blegtorale, edhe nëse kanë tokë në pronësi ose në përdorim, me vendndodhje në rrethin fqinj, që paguajnë kontribute në mënyrë të detyrueshme për barrë lindje, për pensione dhe për sigurimin e kujdesit shëndetësor.

k) Nxënësit punëmarrës, që ndjekin arsimin dhe formimin profesional në formën e dyfishtë në kualifikimet e niveleve 2 deri në 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe që nënshkruajnë një kontratë pune për mësimin e profesionit, me pagesë mujore, për të cilët paguhen kontribute nga punëdhënësi në nivelin minimal, vetëm për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, për kohëzgjatjen e kontratës.

2. Personat me mandat kushtetues, të punësuarit e emëruar dhe personat e tjerë që trajtohen nga skemat e sigurimeve shoqërore suplementare, ushtarakët e Forcave të Armatosura, punonjësit e Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri, personat me tituj shkencorë, profesorë, asistentë profesorë, drejtues kërkimesh dhe mjeshtër kërkimesh, të cilët derdhin kontribut suplementar të detyrueshëm, për përfitimin e pensionit suplementar.

3. Personat e punësuar në miniera, në nëntokë, të cilët paguajnë kontribute të detyrueshme shtesë për degën e pensioneve.

4. Personat me banim të përhershëm në Shqipëri, me të ardhura të rregullta nga pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, të cilët paguajnë kontribute të detyrueshme vetëm për sigurimin e kujdesit shëndetësor. Në këtë rast, kontributi i detyrueshëm zbatohet vetëm kur personi me të ardhura të rregullta nga pronësia nuk ka sigurim tjetër të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor.

5. Të papunët, që përfitojnë pagesë papunësie për periudhën që trajtohen me këtë pagesë, për të cilët

buxheti i shtetit derdh kontribute për degën e pensioneve dhe për barrë lindje.

6. Personat nën pagesë kalimtare apo pension të parakohshëm, sipas dispozitave të ligjeve nr.10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, ish-punonjësit që kanë punuar në miniera, në nëntokë, dhe ish-punonjësit e industrisë ushtarake, që përfitojnë trajtim financiar të veçantë, personat që u shërbejnë invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe gratë, që dalin në pension për periudhën e kryerjes së arsimit të lartë, të cilët sigurohen, në mënyrë të detyrueshme, nga buxheti i shtetit, vetëm në degën e pensioneve.

7. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, të punësuar, punëdhënës ose të vetëpunësuar në subjekte të regjistruara për efekte fiskale në Republikën e Shqipërisë, mbrohen dhe sigurohen, në mënyrë të detyrueshme, sipas përcaktimeve në pikën “1”, të këtij kreu.

8. Nga mbrojtja dhe siguri i detyrueshëm shoqëror përjashtohen shtetasit e huaj që:

a) punojnë në subjekte të huaja, të cilat, në bazë të një marrëveshjeje, nuk kanë detyrimin për t’u regjistruar në organet tatimore shqiptare;

b) janë të punësuar në subjekte të huaja, që nuk kanë detyrimin për t’u regjistruar në organet tatimore shqiptare, të cilët vijnë në Shqipëri të punojnë në një punë apo shërbim të kualifikuar, sipas një kontrate shërbimi, të lidhur me një subjekt të regjistruar në organet tatimore shqiptare, i cili nuk është degë apo njësi e subjektit kontraktor. Zgjatja e kohës së qëndrimit dhe shërbimit është sipas përcaktimeve në ligjin nr.108/2013 “Për të huajt”;

c) janë të punësuar në subjekte të huaja, të cilat nuk kanë detyrimin për t’u regjistruar në organet tatimore shqiptare, të cilët dërgohen në Shqipëri të punojnë në një punë apo shërbim të caktuar, sipas një kontrate të lidhur nga subjekti i huaj punëdhënës me një subjekt të regjistruar në organet tatimore shqiptare, i cili nuk është degë apo njësi e subjektit kontraktor, kur plotësohen kushtet, si më poshtë vijon:

i) Të ketë një marrëveshje për shmangien e taksimit të dyfishtë, të lidhur midis shtetit shqiptar dhe shtetit të subjektit punëdhënës të huaj;

ii) Procedura e regjistrimit, leja e punës dhe kohëzgjatja e saj të jenë kryer në përputhje me dispozitat e ligjit nr.108/2013 “Për të huajt”;

iii) Rezidenca dhe detyrimet për pagesë, sipas legjislacionit fiskal, të zbatohen sipas përcaktimeve në ligjin nr.9920, datë 9.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

iv) Subjekti kontraktues, i regjistruar në organet tatimore shqiptare, kërkon çdo 3 muaj, nga subjekti punëdhënës i huaj, dokument të konfirmuar nga strukturat e sigurimeve shoqërore të shtetit përkatës lidhur me pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore, të shoqëruar me listën emërore të punonjësve të huaj, të cilën e administrojnë së bashku me dokumentet e transfertave në favor të punëdhënësit të huaj.

c) me rezidencë e banim të përhershëm jashtë territorit të Shqipërisë, të cilët kanë veprimtari të regjistruara në emrin e tyre në të dyja shtetet ku kryejnë detyrën e administratorit, së bashku me një administrator tjetër, me rezidencë të përhershme në Shqipëri. Në këtë rast, personat do të jenë subjekt i mbrojtjes dhe i sigurimit të detyrueshëm shoqëror në atë shtet ku kanë rezidencën dhe, njëkohësisht, të vërtetojnë me dokument mbrojtjen me sigurim shoqëror nga shteti përkatës. Rezidenca e ka kuptimin sipas përcaktimeve në ligjin nr.9920, datë 9.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

d) që janë të përjashtuar nga pagimi i kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe të sigurimit të kujdesit shëndetësor në Shqipëri, në bazë të një marrëveshjeje të lidhur midis shtetit të tyre me shtetin shqiptar.

9. Përjashtohen nga pagesa e kontributeve të detyrueshme të sigurimit të kujdesit shëndetësor personat ekonomikisht aktivë, që nuk janë me banim të përhershëm në Shqipëri, që janë të punësuar, të vetëpunësuar, punonjës të papaguar të familjes dhe personat me të ardhura të rregullta nga pasuritë e luajshme dhe të paluajshme dhe burime të tjera të krahasueshme.

II. PAGA PËR EFEKT TË LLOGARITJES SË KONTRIBUTEVE

1. Paga bruto, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore e të kujdesit shëndetësor, është paga e caktuar sipas legjislacionit në fuqi, ose në kontratën e punës, sipas rastit, me kohë ose vëllim pune dhe shtesat e tjera, me karakter të përhershëm, që lindin nga marrëdhëniet e punës. Paga bruto evidentohet në listëpagesën tip, e cila është deklaratur për pagesë dhe dokumenti bazë për evidentimin e kontributeve individuale.

2. Në pagën bruto, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe sigurimit të kujdesit

shëndetësor, nuk përfshihen:

- a) përfitimet që punëmarrësi merr nga fondet e sigurimeve shoqërore;
- b) kompensimet nga rritja e çmimeve;
- c) dhuratat në të holla, që nuk kanë karakter të përhershëm dhe të përgjithshëm;
- ç) të ardhurat nga detyrimi ushqimor, të caktuara me vendim gjykate;
- d) vlera e antidoteve, që punëdhënësi jep në natyrë, për personat e punësuar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) shpërblimet me karakter jo të përhershëm, të lejuara në mbështetje të legjislacionit në fuqi, shpërblimet nga fondi i veçantë, për rastet e fatkeqësive në familje, për sëmundjet e gjata, për dëme, në raste fatkeqësish të mëdha natyrore, dhe për veprimtari të shquara;
- e) vlera e shpenzimeve për të punësuarit, që kryejnë veprimtari jashtë qendrës së banimit, të cilat jepen bazuar në legjislacionin në fuqi dhe që nuk janë pjesë e pagës;
- ë) honorarët apo shpërblimet e tjera të kësaj natyre, që nuk kanë lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës.

3. Paga bruto mujore, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve shoqërore, të jetë, si më poshtë vijon:

a) jo më pak se sa paga minimale mujore në shkallë vendi, e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të nenit 111, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1996, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", dhe deri në një pagë maksimale që llogaritet sipas përcaktimeve në paragrafin e dytë, të nenit 10, të ligjit nr. 7703, datë 1.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për personat e punësuar;

b) jo më pak se sa paga minimale në shkallë vendi, dhe nëse e kërkon vetë personi deri në pagën maksimale për efekt të llogaritjes së kontributeve;

c) e barabartë me pagën minimale mujore në shkallë vendi për punonjësit e papaguar të familjes me të cilët i vetëpunësuari punon e bashkëjeton ligjërisht;

c) mund të jetë më e ulët se paga minimale në shkallë vendi, në varësi të kohës efektive të punës, për invalidët e punësuar, të vetëpunësuar dhe anëtarë të papaguar të familjes, të cilët marrin pension invaliditeti të pjesshëm, si më poshtë vijon:

i. për invalidët e vetëpunësuar dhe anëtarët e papaguar të familjes invalidë, të cilët marrin pension invaliditeti të pjesshëm, mund të jetë deri në 25% më e ulët se paga minimale;

ii. për invalidët e punësuar, të cilët marrin pension invaliditeti të pjesshëm, të jetë sipas kohës së punës dhe pagës faktike, por jo më pak se 50% e pagës minimale dhe jo më shumë se paga maksimale e përcaktuar për efekt të derdhjes së kontributeve.

4. Paga mujore, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimit të kujdesit shëndetësor, nga data 1.1.2015 e në vazhdim, të jetë, si më poshtë vijon:

a) jo më pak se sa paga minimale në shkallë vendi dhe deri në shumën e pagës bruto, sipas deklaratës së listëpagesës, për personat e punësuar;

b) sa dyfishi i pagës minimale në shkallë vendi, për personat e vetëpunësuar dhe punonjësit e papaguar të familjes me të cilët i vetëpunësuari punon e bashkëjeton ligjërisht;

c) paga minimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimit të kujdesit shëndetësor, për personat e vetëpunësuar në bujqësi, është 4 620 (katër mijë e gjashtëqind e njëzet) lekë.

5. Paga mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve suplementare të detyrueshme, të jetë jo më pak se sa paga minimale në shkallë vendi dhe deri në shumën e pagës bruto, sipas deklaratës së listëpagesës.

Paga referuese në zbatim të ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, të ndryshuar, është paga bazë për titullin në institucionet publike, duke përfshirë shtesat për funksion. Paga bazë për titullin të jetë paga mujore korresponduese, e përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave, në të cilin pasqyrohet trajtimi me pagë dhe shtesa mbi pagë i personelit të institucioneve publike të arsimit të lartë në momentin e derdhjes së kontributeve.

6. Paga, për efekt të llogaritjes së kontributeve shtesë, në zbatim të ligjit nr. 150/2014, "Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë", dhe nenit 8, të ligjit nr. 29/2019, "Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji", të jetë sipas përcaktimeve në shkronjën "a", të pikës 3, të këtij kreu.

7. Paga mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të buxhetit të shtetit, për kohën e trajtimit me pagesë kalimtare apo pension të parakohshëm të personave që kryenin funksione kushtetuese apo si punonjës të lartë të shtetit dhe për ish-ushtarakët, punonjësit e Policisë së Shtetit, të Shërbimit Informativ, të Gardës së Republikës, të Policisë së Burgjeve e Mbrojtjes nga Zjarri dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm është e barabartë me pagën referuese, sipas gradës dhe funksionit, në momentin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.

8. Paga mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të buxhetit të shtetit për personat që përfitojnë pagesë papunësie, për ish-punonjësit që kanë punuar në miniera, në nëntokë, dhe ish-punonjësit e industrisë ushtarake, që përfitojnë trajtim financiar të veçantë, personat që u shërbejnë invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe gratë që dalin në pension për periudhën e kryerjes së arsimit të lartë, është e barabartë me pagën minimale.

III. LLOJET, SHUMA DHE SHPËR-NDARJA E KONTRIBUTEVE

Llojet, shpërndarja sipas degëve e skemave të sigurimit dhe masa e kontributeve, nga data 1.1.2015 e në vazhdim, janë, si më poshtë:

1. Shuma minimale mujore e kontributeve i referohet pagës minimale dhe normës së kontributit. Kontributi minimal mujor, sipas degëve dhe skemave të sigurimit, është 6 138 (gjashtë mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) lekë dhe ndahet, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	norma në %	shuma në lekë
I	Totali i kontributit të sigurimit shoqëror	24.50	5 390
1	Dega e sigurimit të sëmundjeve	0.30	66
2	Dega e sigurimit të barrëlindjeve	1.40	308
3	Dega e sigurimit të pensioneve	21.60	4 752
4	Dega e sigurimit të aksidenteve	0.30	66
5	Dega e sigurimit të papunësisë	0.90	198
II	Kontributi i sigurimit të kujdesit shëndetësor	3.40	748
	Gjithsej	27.90	6 138

2. Shuma minimale mujore e kontributit të sigurimit të kujdesit shëndetësor për të vetëpunësuarit dhe punonjësit e papaguar të familjes, me përjashtim të të vetëpunësuarve në bujqësi, të jetë 3.4% e dyfishit të pagës minimale mujore, të përcaktuar për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimit të kujdesit shëndetësor, e barabartë me 1 496 (një mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë.

3. Kontributi i detyrueshëm për të punësuarit me kontratë pune, që zgjat më shumë se 87 orë në muaj, të jetë:

a) për sigurimet shoqërore, 24.5% të pagës bruto, sipas listëpagesës, ku pjesa e punëdhënësit të jetë 15.0% dhe pjesa e të punësuarit 9.5%, por jo më pak se paga minimale dhe jo më shumë se paga maksimale, e përcaktuar në këtë vendim, për efekt të llogaritjes së kontributeve shoqërore;

b) për sigurimin e kujdesit shëndetësor, 3.4% të pagës bruto, sipas listëpagesës, ku pjesa e punëdhënësit të jetë 1.7% dhe pjesa e të punësuarit 1.7%, por jo më pak se paga minimale, e përcaktuar në këtë vendim, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimit të kujdesit shëndetësor.

4. Kontributi i detyrueshëm për të punësuarit me kontratë pune, që zgjat më pak se 87 orë në muaj, të jetë:

a) për sigurimet shoqërore, 23.3% të pagës bruto, sipas listëpagesës, ku pjesa e punëdhënësit të jetë 13.9% dhe pjesa e të punësuarit 9.4%, por jo më pak se paga minimale dhe jo më shumë se paga maksimale, e përcaktuar në këtë vendim, për efekt të llogaritjes së kontributeve shoqërore;

b) për sigurimin e kujdesit shëndetësor, 3.4% të pagës bruto, sipas listëpagesës, ku pjesa e punëdhënësit të jetë 1.7% dhe pjesa e të punësuarit 1.7%, por jo më pak se paga minimale e përcaktuar në këtë vendim, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimit të kujdesit shëndetësor.

5. Kontributi i detyrueshëm, për të punësuarit me kontratë pune që zgjat më pak se 1 javë, të jetë:

a) për sigurimet shoqërore, 0.3% të pagës bruto, të realizuar gjatë ditëve të punës dhe përballohet nga punëdhënësi;

b) për sigurimin e kujdesit shëndetësor, 3.4% të pagës bruto, të realizuar gjatë ditëve të punës, ku pjesa e punëdhënësit të jetë 1.7% dhe pjesa e të punësuarit 1.7%.

6. I vetëpunësuarit dhe i vetëpunësuarit që punëson të tretë, me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi, të paguajë për vete një kontribut të detyrueshëm për sigurimet shoqërore, në masën 23% të pagës, por jo më pak se paga minimale mujore dhe sipas përcaktimit të vetë personit, deri në nivelin e pagës maksimale për efekt të kontributeve shoqërore.

7. I vetëpunësuarit dhe i vetëpunësuarit që punëson të tretë, me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi, të paguajë për vete një kontribut të detyrueshëm për sigurimin e kujdesit shëndetësor, në masën 3.4% të dyfishit të pagës minimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve, e barabartë me 1 496 (një mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë në muaj.

8. I vetëpunësuarit, për pjesëtarët e familjes së tij, që nuk trajtohen me pagë, por që punojnë e bashkëjetojnë me të ligjërisht, me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi, të paguajë kontribut të detyrueshëm për sigurimet shoqërore, në masën 23% të pagës mujore minimale prej 22 000 (njëzet e dy mijë) lekësh, e barabartë me 5 060 (pesë mijë e gjashtëdhjetë) lekë në muaj.

9. I vetëpunësuarit, për pjesëtarët e familjes së tij, që nuk trajtohen me pagë, por që punojnë e bashkëjetojnë me të ligjërisht, me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi, të paguajë një kontribut të detyrueshëm për sigurimin e kujdesit shëndetësor, në masën 3.4% të dyfishit të pagës minimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve, e barabartë me 1 496 (një mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë në muaj.

10. Personat mbi moshën 18 vjeç, me të ardhura të rregullta nga pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, që nuk kane sigurim tjetër të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, të paguajnë një kontribut të detyrueshëm për sigurimet shëndetësore, në masën 3.4% të dyfishit të pagës minimale mujore, e barabartë me 1 496 (një mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë në muaj.

11. Kontributi i detyrueshëm për aksidente në punë dhe sëmundje profesionale, për kohën e formimit

profesional, të personave të punësuar në subjekte që zhvillojnë veprimtari ekonomike sipas Regjimit të Përpunimit Aktiv (fason), është 0.3% e pagës bruto minimale në shkallë vendi dhe paguhet totalisht nga punëdhënësi.

12. Për nxënësit e shkollave, të mesme apo profesionale, dhe studentët, për kohën e programuar të praktikës mësimore, kontributi i detyrueshëm për aksidente në punë dhe sëmundje profesionale të jetë 0.3% e pagës bruto minimale. Kontributet paguhen nga subjekti ku kryhet praktika dhe për atë kohë sa është përcaktuar në kontratën e lidhur ndërmjet tij dhe institucionit përgjegjës ose nga institucioni përgjegjës.

13. *Personat e vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbimi, ambulantë, të deklarojnë dhe të paguajnë kontribut minimal mujor në shumën 4 696 (katër mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë, nga të cilat 3 200 (tre mijë e dyqind) lekë për sigurime shoqërore dhe 1 496 (një mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë për sigurimin e kujdesit shëndetësor.*

14. *Për personat që punojnë si punëtorë shtëpie, punëdhënësi të deklarojë dhe të paguajë kontribut minimal mujor në shumën 3 948 (tre mijë e nëntëqind e dyzet e tetë) lekë, nga të cilat 3 200 (tre mijë e dyqind) lekë për sigurime shoqërore dhe 748 (shtatëqind e dyzet e tetë) lekë për sigurimin e kujdesit shëndetësor.*

15. Llogaritja dhe deklarimi i kontributeve mujore, për personat që janë ekonomikisht aktivë në më shumë se një subjekt juridik ose fizik, bëhet, si më poshtë:

a) Kur i njëjti person është ekonomikisht aktiv në dy ose më shumë subjekte dhe në secilin prej tyre merr pagë më të lartë se paga minimale, llogaritja e kontributit të sigurimit shoqëror dhe sigurimit të kujdesit shëndetësor është e detyrueshme për çdo subjekt. Në këtë rast, llogaritja e kontributit të sigurimit të kujdesit shëndetësor bëhet sipas pagës përkatëse, që merr nga secili subjekt, ndërsa masa e llogaritur e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në total, të jetë jo më shumë se kontributi i llogaritur mbi pagën maksimale;

b) Kur i njëjti person është ekonomikisht aktiv në dy ose më shumë subjekte, dhe në njërin prej tyre paga është më e vogël se paga minimale, llogaritja e kontributit të sigurimit shoqëror dhe sigurimit të kujdesit shëndetësor është e detyrueshme për çdo subjekt. Në këtë rast, llogaritja e kontributit të sigurimit të kujdesit shëndetësor bëhet sipas pagës përkatëse, që merr nga secili subjekt, ndërsa llogaritja për kontributet e sigurimeve shoqërore, në total, të jetë jo më shumë se kontributi i llogaritur mbi pagën maksimale;

c) Kur i njëjti person, për shkak të natyrës së punës si punonjës pastrimi, punonjës mirëmbajtjeje, lulishtar, e të tjerë të kësaj natyre, është i punësuar në dy ose më shumë subjekte, me orar të reduktuar gjatë ditës dhe puna e kryer në secilin subjekt llogaritet më e vogël se niveli i pagës minimale, njëri nga subjektet, në marrëveshje me punëmarrësin dhe me të tjerët, konsiderohet si punëdhënësi bazë, i cili merr detyrimin për deklarimin e punonjësit si dhe deklarimin e pagesën e kontributeve të detyrueshme. Puna e kryer tek punëdhënësit e tjerë dokumentohet në një kontratë shërbimi, të lidhur midis palëve, ndërsa paga e përgjithshme, për efekt të kontributeve, nuk mund të jetë më e vogël se paga minimale;

ç) Kur një person fizik i vetëpunësuar punon edhe si anëtar i papaguar i familjes ose një familjar punon në dy persona fizikë, që janë familjarë të tij, kontributet llogariten e paguhen në nivelin minimal, pavarësisht se janë ekonomikisht aktivë në dy subjekte;

d) Rregullat e llogaritjes, të deklarimit, përjashtimet dhe rimbursimit të kontributeve të paguara më tepër se detyrimet ligjore, përcaktohen me udhëzim të ministrit të Financave.

dh) *Për personat me titull shkencor, të punësuar në një ose më shumë subjekte, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 10139, datë 15.5.2009, të ndryshuar, të cilët realizojnë një pagë mujore gjithsej të barabartë ose më të madhe se paga e përcaktuar për titullin shkencor përkatës në sektorin publik, kontributi i sigurimit suplementar llogaritet bazuar në pagën referuese të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, sipas titujve, në institucionet publike. Nëse paga referuese e titullit arrihet nga puna vetëm në njërin prej subjekteve, kontributi suplementar për llogaritet vetëm në subjektin e parë, ndërsa në subjektin e dytë nuk llogaritet kontribut. Në rastet kur paga mujore gjithsej, e realizuar në një ose më shumë subjekte, është më e vogël se paga referuese e përcaktuar për titullin shkencor, subjektet përkatëse nuk llogarisin kontribut suplementar dhe për rrjedhojë muaji pa kontribut, nuk njihet si periudhë për përfutime suplementare.*

e) Kur i njëjti person i plotëson kushtet për pjesëmarrje në më shumë se një nga skemat e sigurimit suplementar, në të njëjtin muaj, ai ka të drejtën të zgjedhë pjesëmarrjen dhe pagesën e kontributeve, vetëm në njërin nga skemat suplementare. Zgjedhja e skemës bëhet nga personi i interesuar dhe i njoftohet punëdhënësit.

ë) Rimbursimi i kontributeve të paguara më tepër se kontributi i llogaritur mbi pagën maksimale mujore mbi të cilën llogariten kontributet bëhet nga subjekti përkatës me kërkesë e miratim në organet tatimore, nëpërmjet rivlerësimit të listëpagesave, duke e kaluar shumën e mbipaguara të kontributit të sigurimeve shoqërore:

i. në mbulim të detyrimeve kontributive të personit për periudhat e ardhshme;

ii. duke kthyer shumën e mbipaguara;

iii. rregullat e llogaritjes së kontributeve, të deklarimit dhe të rimbursimit të kontributeve të paguara më tepër se detyrimet ligjore, përcaktohen me udhëzime të ministrit përgjegjës për financat.

16. Të vetëpunësuarit në bujqësi të derdhin kontribut vjetor për sigurimet shoqërore në masën 38 400 (tridhjetë e tetë mijë e katërqind) lekë, me përjashtim të të vetëpunësuarve që banojnë në rrethet Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë dhe Tropojë, për të cilët masa e kontributit vjetor është 29 400 (njëzet e nëntë mijë e katërqind) lekë.

17. Të vetëpunësuarit në bujqësi të derdhin kontribut mujor, për sigurimin e kujdesit shëndetësor, në masën 3.4% të dyfishit të pagës minimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimit të kujdesit shëndetësor, të barabartë me një vlerë prej 314 (treqind e katërmëdhjetë) lekë në muaj.

18. Për personat që kryejnë funksione kushtetuese, si dhe punonjësit e lartë të shtetit, për ish-ushtarakët, punonjësit e Policisë së Shtetit, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Gardës së Republikës, të Policisë së Burgjeve, Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, dhe punonjësit të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, gjatë kohës së trajtimit me pagesë kalimtare ose pension të parakohshëm, buxheti i shtetit derdh kontribute, për degën e pensioneve, në masën 21.6% të pagës mesatare referuese, sipas gradës dhe funksionit në momentin e përfundimit të funksionit, e indeksuar çdo vit me koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësuar.

19. Për ish-punonjësit që kanë punuar në miniera në nëntokë dhe ish-punonjësit e industrisë ushtarake që përfitojnë trajtim financiar të veçantë, personat që u shërbejnë invalidëve paraplegjikë e tetraplegjikë dhe gratë që dalin në pension, për periudhën e kryerjes së arsimit të lartë, buxheti i shtetit derdh kontribute për degën e pensioneve në masën 21.6% të pagës minimale në shkallë vendi. Për personat që u shërbejnë invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, duke filluar nga data 1.1.2015 e në vazhdim, buxheti i shtetit derdh kontribute edhe për degën e barrë lindjeve dhe aksidenteve në punë në masën 1.7 % të pagës minimale në shkallë vendi.

20. Për të papunët, që përfitojnë pagesë papunësie, për periudhën që trajtohen me këtë pagesë, buxheti i shtetit derdh kontribute për degën e pensioneve dhe për barrë lindje, në masën 23% të pagës minimale në shkallë vendi.

21. Për ish-punonjësit që kanë punuar në miniera në nëntokë dhe ish-punonjësit e industrisë ushtarake që përfitojnë trajtim financiar të veçantë, personat që u shërbejnë invalidëve paraplegjikë e tetraplegjikë dhe gratë që dalin në pension, për periudhën e kryerjes së arsimit të lartë, buxheti i shtetit derdh kontribute për degën e pensioneve në masën 21.6% të pagës minimale. Për personat që u shërbejnë invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, duke filluar nga data 1.1.2015 e në vazhdim, buxheti i shtetit derdh kontribute edhe për degën e barrë lindjeve dhe aksidenteve në punë në masën 1.7 % të pagës minimale.

22. Për personat që kryejnë funksione kushtetuese si dhe punonjësit e lartë të shtetit, për ish-ushtarakët, punonjësit e Policisë së Shtetit, të Shërbimit Informativ, të Gardës së Republikës, të Policisë së Burgjeve e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe punonjësit të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, gjatë kohës së trajtimit me pagesë kalimtare ose pension të parakohshëm, buxheti i shtetit derdh kontribute, për degën e pensioneve, në masën 21.6% të pagës mesatare referuese, sipas gradës dhe funksionit, të indeksuar çdo vit me koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësuar.

23. Për nxënësin punëmarrës, që ndjek arsimin dhe formimin profesional, në formën e dyfishtë në kualifikimet e niveleve 2 deri në 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, që nënshkruan një kontratë pune për mësimin e profesionit me pagesë, kontributi i detyrueshëm për aksidente në punë dhe sëmundjet profesionale është në vlerën 0.3% të pagës bruto minimale në shkallë vendi dhe përballohet nga kompania trajnuese për arsimin e dyfishtë.

IV. REGJISTRIMI DHE EVIDENTIMI I KONTRIBUTEVE

1. Subjektet juridikë e fizikë, edhe për efekt të deklarimit të pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe të sigurimit të kujdesit shëndetësor, regjistrohen në organet tatimore, sipas përcaktimit në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Kryefamiljarët, që punësojnë persona si punëtorë shtëpie, i rregullojnë marrëdhëniet e punës nëpërmjet një kontrate me shkrim ndërmjet palëve, ku, veç të tjerave, shënohen, detyrimisht, numri personal i identifikimit të personit të punësuar, koha e fillimit të punës, zgatja e saj “me ose pa afat”, si dhe paga mujore bruto. Në këtë rast, kryefamiljari përcaktohet në rolin e punëdhënësit dhe, si i tillë, ka detyrimin për regjistrim në organet tatimore dhe për pajisjen, nga këto organe, me numrin e identifikimit të personit të tatuashëm (NIPT-in).

3. Regjistrimi dhe çregjistrimi nga organet tatimore, i kryefamiljarëve që punësojnë persona si punëtorë shtëpie dhe i personave të vetëpunësuar në veprimtari tregtare, shërbimi apo ambulante, bëhet sipas një procedure të thjeshtuar, që përcaktohet me udhëzim nga ministri i Financave.

4. Formimi profesional nëpërmjet punës, sipas përcaktimeve në kreun I, realizohet nga punëdhënësi që zhvillon aktivitet ekonomik, sipas Regjimit të Përpunimit Aktiv (fason). Koha e formimit profesional të personit, për një profesion të caktuar të kualifikuar, mund të zgjatë deri në tre muaj gjithsej dhe vetëm një herë, pavarësisht nga subjektet ku është kryer. Lista e personave pjesëmarrës, periudha e formimit profesional dhe profesioni për të cilin do të kualifikohen deklarohet zyrtarisht nga subjekti, në zyrën përkatëse të punësimit, përpara fillimit të trajnimit. Zyra e punësimit bën evidentimin në një regjistër të veçantë dhe autorizon subjektin për vazhdimin e procesit dhe deklarimin në organet tatimore.

5. Punëdhënësi bën sigurimin e punëmarrësit, duke filluar nga data e fillimit të punës, sipas përcaktimit në kontratën e punës apo në aktin e emërimit dhe vazhdon të paguajë kontribute çdo muaj, gjatë të gjithë kohës që vazhdojnë marrëdhëniet e punës.

6. Kur fillimi dhe ndërprerja përfundimtare e marrëdhënieve të punës bëhen gjatë muajit, si dhe kur gjatë muajit ka ndërprerje të përkohshme, për shkak të përfitimeve afatshkurtra nga skema e sigurimeve shoqërore, kontributet llogariten e paguhen në bazë të pagës së realizuar gjatë ditëve të punës.

7. Punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit e kryejnë deklarimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe të sigurimit të kujdesit shëndetësor në total dhe për çdo person, në formë elektronike, në sistemin informatik të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, e cila siguron edhe mbajtjen elektronike të të dhënave të kontributeve të deklaruara nga subjekti, të pagesave të kryera, si dhe të detyrimeve që lindin nga vlerësimet dhe mospagesat.

8. Të vetëpunësuarit në bujqësi regjistrohen në organet e sigurimeve shoqërore pas paraqitjes së këtyre dokumenteve:

- a) certifikatës familjare të gjendjes civile;
- b) vërtetimin e pronësisë mbi tokën, lëshuar nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, pranë organeve të pushtetit vendor, dhe/ose
- c) vërtetimin mbi tokën e marrë në përdorim, lëshuar nga strukturat përkatëse, pranë organeve të pushtetit vendor, dhe/ose
- ç) kontratën e qiramarrjes së tokës bujqësore, të noterizuar;
- d) vërtetimin e lëshuar nga komuna ose bashkia, ku cilësohet se personi ushtron veprimtari bujqësore/blektorale.

9. Të vetëpunësuarit në bujqësi i paguajnë kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe të sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor individualisht, një herë në tre muaj. Afati i pagesës së kontributeve është jo më vonë se dita e fundit e muajit të tretë, brenda çdo tremujori kalendarik.

10. Të vetëpunësuarit në bujqësi, të cilët nuk arrijnë të plotësojnë kushtin minimal të periudhës së sigurimit, për të përfituar pension mund të kryejnë pagesa kontributesh edhe pas plotësimit të moshës për pension, por me kusht që ato t’u korrespondojnë periudhave para plotësimit të moshës për pension dhe

për këto periudha do të paguhet sipas masës së kontributit të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, për vitin kur kryhet pagesa.

11. Të vetëpunësuarit në bujqësi paguajnë kontributet për sigurimet shoqërore dhe për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, *për vitin 2020* e në vazhdim, pavarësisht se mund të jenë të pasiguruar për vitet pararendëse. Periudhat për të cilat nuk janë paguar kontributet nuk njihen periudha sigurimi.

12. Të vetëpunësuarit në bujqësi, të cilët nuk i kanë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore për periudhat e kaluara, por që i kanë patur kushtet për t'u siguruar si të vetëpunësuar në bujqësi, pavarësisht nga vendbanimi aktual, mund t'i paguajnë kontributet për këto periudha, sipas masës së kontributit, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, për vitin kur kryhet pagesa.

12/1. Shumat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe kamatëvonesave të paguara për ato periudha që personat nuk i plotësonin kushtet e kriteret për t'u siguruar si të vetëpunësuar në bujqësi dhe, për rrjedhojë, nuk përfitojnë subvencionin e buxhetit të shtetit, për pagesat e kryera brenda pesë viteve nga data e konstatimit apo data e kërkesës drejtuar organeve të sigurimeve shoqërore për kthimin e tyre, i kthehen atyre të plota. Këto shuma, me marrëveshje midis palëve, mund të konvertohen edhe si periudha sigurimi, në nivel minimal, në skemën e sigurimit shoqëror vullnetar, me kuotat e kontributit të kësaj skeme për vitet përkatëse korresponduese për të cilat ishte bërë sigurimi si i vetëpunësuar në bujqësi.

Në rastet kur nga data e pagesës e deri në datën e konstatimit apo datën e kërkesës drejtuar organeve të sigurimeve shoqërore kanë kaluar pesë vjet, me marrëveshje midis palëve, shumat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe kamatëvonesave të paguara konvertohen si periudha sigurimi në nivel minimal në skemën e sigurimit shoqëror vullnetar me kuotat e kontributit të kësaj skeme të viteve përkatëse korresponduese për të cilat ishte bërë sigurimi si i vetëpunësuar në bujqësi.

Procedurat e kthimit të shumave të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe kamatëvonesave të paguara apo procedurat e konvertimit të tyre në kontribute në skemën e sigurimit shoqëror vullnetar përcaktohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

12/2 Për efekt të përfitimeve sipas dispozitave të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, do të njihen si periudha sigurimi të gjitha periudhat nga 1.10.1993 deri më 31.12.2014, për të cilat nga personat e vetëpunësuar në bujqësi janë paguar kontributet e sigurimit të detyrueshëm shoqëror, sipas procedurave të kohës, të përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 402, datë 11.6.2001, nr. 167, datë 29.3.2006, dhe nr. 1114, datë 30.7.2008, "Për disa çështje në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", pavarësisht vendbanimit të tyre sipas regjistrit të gjendjes civile në atë periudhë të mbuluar me sigurim shoqëror, me kusht që kontributet të jenë paguar deri në datën 31.3.2015".

13. Nuk është i detyrueshëm sigurimi dhe nuk mund të llogariten detyrimet e kontributeve e të kamatëvonesave për pjesëtarët e familjeve bujqësore, për periudhën që përfitojnë ndihmë ekonomike, sipas ligjit nr.9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmat dhe shërbimet shoqërore". Periudhat, për të cilat nuk janë paguar kontributet, nuk njihen periudha sigurimi.

14. Për efekt të përfitimeve afatshkurtra nga sigurimet shoqërore dhe të përfitimeve të shërbimeve nga sigurimi i kujdesit shëndetësor, vlerësohen të siguruar për tremujorin pasardhës:

a) të vetëpunësuarit, pjesëtarët e papaguar të familjes, të vetëpunësuarit në veprimtari ambulante, nëse i kanë paguar kontributet e tremujorit pararendës brenda datës 20 të muajit pasardhës, pas mbarimit të tremujorit;

b) punëmarrësit e punësuar tek i vetëpunësuarit, i cili ka statusin "i vetëpunësuar me punëmarrës", nëse i kanë paguar kontributet e tremujorit pararendës përpara lindjes së të drejtës për përfitime;

c) të vetëpunësuarit në bujqësi, nëse i kanë paguar kontributet e tremujorit pararendës jo më vonë se dita e fundit e muajit të tretë, brenda çdo tremujori kalendarik;

ç) Këta persona, përpara fillimit të trajtimit me përfitime, paguajnë kontributet e tremujorit në vazhdim, nga dita e parë dhe deri në ditën kur lind e drejta e përfitimit.

15. Kontributi vullnetar llogaritet në kufijtë e pagës minimale dhe maksimale, të caktuar nga Këshilli i Ministrave, dhe paguhet nga personi i siguruar në afatin e përcaktuar në kontratën e sigurimit vullnetar.

16. Kontributet e buxhetit të shtetit, për të papunët që përfitojnë pagesë papunësie, për ish-punonjësit që kanë punuar në miniera, në nëntokë, dhe ish-punonjësit e industrisë ushtarake, që përfitojnë trajtim

financiar të veçantë, personat që u shërbejnë invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, për gratë që dalin në pension për periudhën e kryerjes së arsimit të lartë, për personat që kanë kryer funksione kushtetuese dhe si ish-punonjës të lartë të shtetit dhe për ish-ushtarakët, punonjësit e Policisë së Shtetit, të Shërbimit Informativ Shtetëror, të Gardës së Republikës, të Policisë së Burgjeve e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shërbimit, të Kontrollit të Brendshëm, gjatë kohës së trajtimit me pagesë kalimtare ose pension të parakohshëm, derdhen çdo muaj, nga buxheti i shtetit në Fondin e Sigurimeve Shoqërore. Procedurat e llogaritjes dhe të pagesës përcaktohen me udhëzim të ministrit të Financave.

17. Kontributet e llogaritura dhe të derdhura evidentohen në bazën e të dhënave, të krijuar për këtë qëllim. Instituti i Sigurimeve Shoqërore evidenton kontributet individuale të personave të siguruar sipas numrit personal i identifikimit. Kontributet për shtetasit e huaj evidentohen sipas numrit të sigurimit dhe, në rastet kur nuk ekziston, të përdoret numri personal i identifikimit që personi ka në pasaportë. Procedurat e evidentimit, dokumentacioni bazë dhe kontrolli i saktësisë së mbartjes së të dhënave, nga dokumentet bazë në kartelat individuale të kontributeve, përcaktohet me rregullore të miratuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

18. Libreza e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe sigurimit të kujdesit shëndetësor është dokumenti me të cilin pajiset çdo kontributpagues, që evidenton kontributet e paguara dhe shërben si dokument bazë individual për realizimin e së drejtës për përfitime e shërbime. Instituti i Sigurimeve Shoqërore realizon prodhimin dhe plotëson kërkesat e punëdhënësve dhe të vetëpunësuarve me librezat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, kundrejt pagesës së çmimit nga ana e tyre.

19. Personat juridikë punëdhënës pajisin të punësuarit me librezën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe i plotësojnë ato çdo muaj, në datën e pagesës së pagës mujore.

20. Për të vetëpunësuarit dhe pjesëtarët e familjes, për punëmarrësit e punësuar tek i vetëpunësuarit, që ka statusin “i vetëpunësuar me punëmarrës”, për personat e vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbimi, ambulante, për personat e vetëpunësuar në bujqësi, si dhe për personat e siguruar vullnetarisht, libreza e kontributeve plotësohet dhe vërtetohet nga strukturat lokale të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

V. PROCEDURAT E KALIMIT TË KONTRIBUTEVE DHE MBLEDHJA E BORSHEVE

1. Kontributet, gjobot dhe interesat e lidhura me to, paguhen nga punëdhënësit dhe nga të vetëpunësuarit në llogaritë bankare të përcaktuara për këtë qëllim, të çelura në bankat e nivelit të dytë, apo edhe nëpërmjet “Postës Shqiptare”, sh.a, për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, e cila është përgjegjëse për administrimin e këtyre llogarive, si për të gjitha llogaritë e tjera, për të ardhurat tatimore. Dokument bazë për pagesën e tyre është urdhërpagesa e printuar nga sistemi informatik, bazuar në deklaratën e listëpagesës, njoftimin e vlerësimit për detyrimet dhe çdo dokument tjetër ligjor, i miratuar për këtë qëllim.

2. Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe të sigurimit të kujdesit shëndetësor, për personat e punësuar si punëtorë shtëpie, paguhen nga kryefamiljari, i përcaktuar si punëdhënës, në bankat e nivelit të dytë, sipas procedurave të vendosura për këtë qëllim. Pagesa e kontributeve bëhet çdo tre muaj, sipas rregullave për pagesat e kontributeve nga personat e vetëpunësuar në biznesin e vogël.

3. Bankat e nivelit të dytë, në fund të çdo dite, raportojnë në mënyrë të hollësishme në Bankën e Shqipërisë dhe në organet tatimore lëvizjen dhe gjendjen progresive të llogarive për kontributet e paguara për sigurimet shoqërore dhe sigurimet e kujdesit shëndetësor. Për gjendjen e këtyre llogarive njoftohet Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit dhe, nëpërmjet saj, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Procedurat e evidentimit, të njoftimit dhe të kalimit të kontributeve në llogaritë e Fondit të Sigurimeve Shoqërore dhe në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor përcaktohen me udhëzim të ministrit të Financave.

4. Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe të sigurimeve të kujdesit shëndetësor nga të vetëpunësuarit në bujqësi dhe të siguruarit në mënyrë vullnetare paguhen në llogaritë bankare apo në zyrat e “Postës Shqiptare”, sh.a., sipas marrëveshjeve, ndërmjet tyre, dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Instituti i

Sigurimeve Shoqërore është përgjegjës për administrimin e tyre.

5. Për personat e vetëpunësuar në bujqësi, shuma e detyrimit kontributiv dhe e kamatëvonesave llogaritet nga organet e sigurimeve shoqërore. Dokument bazë për llogaritjen dhe evidentimin e tij është akt-detyrimi tip, i cili plotësohet nga organet e sigurimeve shoqërore, jo më vonë se tre muaj nga kalimi i afatit ligjor për pagesën e kontributeve ose, përfundimisht, në datën e pagesës së kontributeve. Shuma e detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe kamatëvonesat evidentohet në kontabilitetin e sigurimeve shoqërore, sipas procedurave të miratuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

6. Kontributet vullnetare të sigurimeve të kujdesit shëndetësor paguhen në llogaritë bankare të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

7. Kontributet e papaguara në afatet e përcaktuara, dhe interesat e lidhura me to, vlerësohen detyrim ndaj Fondit të Sigurimeve Shoqërore dhe Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, sipas përkatësisë.

VI. SHKËMBIMI I INFORMACIONIT PËR KONTRIBUTET DHE PAGESAT

1. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, bazuar në procedurën e komunikimit on-line midis sistemeve informatike, të ngritura nga institucionet, dërgon:

a) Në Institutin e Sigurimeve Shoqërore:

i) Deklaratën e listëpagesës me të dhënat përmbledhëse të saj, sipas të gjitha rubrikave, për çdo NIPT;

ii) Shumat e kontributeve dhe interesave, të derdhura sipas NIPT-eve, muajve dhe bankën ku është bërë derdhja;

iii) Listëpagesat për çdo NIPT, me të dhënat sipas të gjitha rubrikave, për çdo person, të identifikuar edhe me numrin personal, shuma e kontributeve e të cilave është derdhur plotësisht;

iv) Të dhënat e mësipërme transmetohen edhe për çdo version të fundit të listëpagesës;

v) Listën e subjekteve aktivë me të dhënat identifikuese dhe numrin e punonjësve.

Të dhënat e mësipërme dërgohen në komunikim on-line, midis sistemeve informatike të ngritura në të dy institucionet. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore hartojnë marrëveshjet dhe protokollat e përbashkëta të shkëmbimeve elektronike.

b) Në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor:

i) Deklaratën e listëpagesës me të dhënat përmbledhëse të saj, sipas të gjitha rubrikave, për çdo NIPT;

ii) Shumat e kontributeve dhe interesave të derdhura sipas NIPT-eve, muajve dhe bankën ku është bërë derdhja;

iii) Listëpagesat për çdo NIPT, me të dhënat sipas të gjitha rubrikave, për çdo person të identifikuar edhe me numrin personal, shuma e kontributeve e të cilave është derdhur plotësisht;

iv) Të dhënat e mësipërme transmetohen edhe për çdo version të fundit të listëpagesës;

v) Listën e subjekteve aktivë, me të dhënat identifikuese dhe numrin e punonjësve.

Të dhënat e mësipërme dërgohen në komunikim on-line midis sistemeve informatike të ngritura në të dy institucionet. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Fondi i Sigurimit Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor hartojnë marrëveshjet dhe protokollat e përbashkëta të shkëmbimeve elektronike.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dërgon në Institutin e Statistikave (INSTAT), të dhënat statistikore për numrin e subjekteve të regjistruara dhe numrin e kontribuesve, sipas veprimtarisë që ushtrojnë.

3. Strukturat në varësi të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dërgojnë në strukturat përkatëse të sigurimeve shëndetësore, zyrtarisht dhe në format elektronik, të dhënat për kontributet e sigurimeve shëndetësore dhe interesat e paguara nga personat e vetëpunësuar në bujqësi, deri në datën 10 të muajit pasardhës të muajit kur është derdhur kontributi.

4. Kur nuk ka të dhëna, për shkak të mosdorëzimit nga tatimpaguesit të deklaratave të listëpagesave, administrimi bëhet në përputhje me përcaktimet e ligjit nr.9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

VII. BAZA E VLERËSUAR

Shuma mujore e përfitimeve varet nga baza e vlerësueshme dhe periudha e sigurimit.

1. *Baza e vlerësuar mesatare mujore, për efekt të llogaritjes së përfutimit, është e barabartë me pagën bruto mujore, mbi të cilën janë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore të periudhës, të realizuar në një ose më shumë subjekte, por jo më shumë se paga maksimale e përcaktuar në kreu II, të këtij vendimi, pjesëtuar me shumën e muajve të periudhës së përcaktuar.*

2. Baza e vlerësuar mujore neto do të jetë shuma që del pasi nga baza e vlerësuar e çdo muaji zbritet tatimi mbi të ardhurat nga puna, shuma e kontributit të sigurimeve shoqërore, të sigurimit të kujdesit shëndetësor dhe të sigurimit suplementar të detyrueshëm, që zbritet nga paga e punonjësit, sipas dispozitave në fuqi.

3. Baza e vlerësuar mesatare mujore neto, për llogaritjen e përfitimeve për sëmundje, barrë lindje, dhe për të ardhura të tjera afatshkurtra, do të jetë shuma e bazës së vlerësuar neto, sipas muajve, pjesëtuar me numrin e muajve të periudhës së caktuar.

4. Baza e vlerësuar mujore, për efekt të llogaritjes së të ardhurave për barrë lindje, për gruan, e cila gjatë periudhës së shtatzënisë ka, së paku, një muaj sigurim, për rastet kur e drejta e përfutimit ka lindur, por përfituesja nuk ka pagë për gjatë 12 muajve të fundit, nga data e lindjes së të drejtës për pagesë, llogaritet duke bashkuar shumën e pagave faktike për muajt që është derdhur kontribut për sigurimet shoqërore, me shumën e pagave minimale, të përcaktuara për efekt të derdhjes së kontributit të sigurimit shoqëror, për muajt pa kontribut, pjesëtuar me 12. Baza e vlerësuar llogaritet në të njëjtën mënyrë edhe për rastet kur përfituesi është bashkëshorti, me kusht që ky i fundit të ketë jo më pak se 12 muaj sigurim, si dhe të jetë i siguruar, së paku, për një muaj nga data e lindjes së fëmijës.

5. Baza e vlerësuar mujore, për efekt të llogaritjes së të ardhurave për invaliditet të plotë ose të pjesshëm, të përhershëm, nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, për rastet kur e drejta e përfutimit ka lindur, por përfituesi nuk ka pagë për gjatë 12 muajve të vitit të fundit, nga data e lindjes së të drejtës për përfitim, llogaritet duke bashkuar shumën e pagave faktike, për muajt që është derdhur kontribut për sigurimet shoqërore, me shumën e pagave minimale, të përcaktuara për efekt të derdhjes së kontributit të sigurimit shoqëror, për muajt pa kontribut, pjesëtuar me 12.

6. Baza e vlerësuar mujore, për efekt të llogaritjes së të ardhurave për sëmundje, nga dita e 15 e raportit mjekësor e në vazhdim, për kompensim sëmundje dhe për llogaritjen e të ardhurave për paaftësi të përkohshme në punë, nga aksidentet ose sëmundjet profesionale, për rastet kur e drejta e përfutimit ka lindur, por përfituesi nuk ka pagë për disa muaj, gjatë 6 muajve të fundit, nga data e lindjes së të drejtës për pagesë, llogaritet duke bashkuar shumën e pagave faktike, për muajt që është derdhur kontribut për sigurimet shoqërore, me shumën e pagave minimale, të përcaktuara për efekt të derdhjes së kontributit të sigurimit shoqëror, për muajt pa kontribut, pjesëtuar me 6.

Për llogaritjen e bazës së vlerësuar mujore neto për punonjësit e dypunësuar merren në llogaritje pagat bruto mbi të cilat janë derdhur kontributet të realizuara në të dyja subjektet dhe zbritjet e bëra nga paga e punonjësit nga secili subjekt për shumat e kontributit, të sigurimeve shoqërore, të sigurimit të kujdesit shëndetësor, të sigurimit suplementar të detyrueshëm, si dhe të tatimit mbi të ardhurat nga punësimi.

Baza e vlerësuar mujore, për efekt të llogaritjes së të ardhurave për sëmundje, nga dita e 15 (pesëmbëdhjetë) e raportit mjekësor e në vazhdim, për kompensim sëmundjeje dhe për llogaritjen e të ardhurave për paaftësi të përkohshme në punë, nga aksidentet ose sëmundjet profesionale, për rastet kur e drejta e përfutimit ka lindur, por përfituesi nuk ka pagë gjatë 6 (gjashtë) muajve të fundit ose për disa muaj, nga data e lindjes së të drejtës për pagesë, për arsye se ka qenë në periudhë përfitimi në një nga degët e sigurimit të detyrueshëm shoqëror është e barabartë me bazën e vlerësuar mujore të llogaritur për efekt të përfitimeve të mëparshme. Përfitimet afatshkurtra për llogaritjen bazuar në bazën e vlerësuar mesatare neto.

7. Baza e vlerësuar mujore neto, për llogaritjen e të ardhurave shtesë për përkujdesje ndaj invalidit, do të jetë shuma që del pasi nga baza e vlerësuar mesatare mujore, mbi të cilën është llogaritur pensioni, zbritet

tatimi mbi të ardhurat personale nga puna, shuma e kontributit të sigurimeve shoqërore, të sigurimit të kujdesit shëndetësor dhe të sigurimit suplementar të detyrueshëm, që zbritet nga paga e punonjësit, sipas dispozitave në fuqi, në momentin e lindjes të së drejtës për përfitim.

8. Baza e vlerësuar mujore, për efekt të llogaritjes së pensionit, për personat e vetëpunësuar në bujqësi, për personat që punojnë si punëtor shtëpie dhe për personat e vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbime ambulante, pavarësisht se kanë paguar kontribute, në bazë të tarifave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, do të jetë e barabartë me pagën minimale, të përcaktuar për efekt të pagesës së kontributeve, në vitin përkatës.

8/1. Baza e vlerësuar, për efekt të llogaritjes së pensionit të pleqërisë për periudhën kur personi ka përfutuar pension invaliditeti të grupit të parë dhe të dytë, para datës 1.1.1994, është paga referuese e përcaktuar në tabelat A1, A2 e A3 të vendimit nr. 561, datë 12.8.2005, të Këshillit të Ministrave, sipas llojit të punës së kryer para invalidizimit, të indeksuara me koeficientët përkatës sipas viteve. Baza e vlerësuar, për efekt të llogaritjes së pensionit të pleqërisë, për periudhën kur personi ka përfutuar pension invaliditeti të plotë apo të ardhura për invaliditet të plotë të përbërshëm nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale pas datës 1.1.1994 deri në momentin e plotësimit të periudhës së detyrueshme të sigurimit sipas nenit 92, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar, është shuma e bazës së vlerësuar mesatare mujore bruto, mbi të cilën është llogaritur pensioni i invaliditetit apo e ardhura për invaliditet të plotë, e indeksuar çdo vit me koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësuar, por, në çdo rast, brenda kufijve të pagës minimale dhe maksimale, të caktuar nga Këshilli i Ministrave, për efekt të pagesës së kontributeve të detyrueshme.

Njihet periudhë sigurimi, për efekt të përfitimit të pensionit të pleqërisë nga data 1.10.1993 e në vazhdim, periudha e trajtimit me pension të plotë invaliditeti, por shuma e viteve të punës para datës 1.1.1994 me vitet e sigurimit pas vitit 1994 dhe periudhën e trajtimit me pension të plotë invaliditeti nuk duhet të kapërcejnë periudhën e detyrueshme të sigurimit të përcaktuar në nenin 92, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar, në momentin kur personit i lind e drejta për pension pleqërie.

8/2. Baza e vlerësuar për efekt të llogaritjes së pensioneve, për kohën e vuajtjes së dënimit me heqje të lirisë të jetë e barabartë me 4 302 (katër mijë e treqind e dy) lekë në muaj, e indeksuar me koeficientët përkatës sipas viteve.

Baza e vlerësuar për efekt të llogaritjes së pensioneve, për kohën e vuajtjes së dënimit me internim, kur internimi është dhënë si dënim penal plotësues, dhe dënimin për kohën e vuajtjes së dënimit për të dëbuarit të jetë e barabartë me 3 494 (tre mijë e katërqind e nëntëdhjetë e katër) lekë në muaj, e indeksuar me koeficientët përkatës sipas viteve.

Në rastet kur paga referuese e llojit të punës, që kishte personi para fillimit të dënimit me heqje lirie, internim apo dënim, ishte më e lartë se masat e mësipërme, si bazë e vlerësuar, për efekt të llogaritjes së pensioneve për periudhën e dënimit, do të jetë paga referuese e llojit të punës para fillimit të dënimit, e përcaktuar në tabelat A1, A2 e A3 të vendimit nr. 561, datë 12.8.2005, të Këshillit të Ministrave, e indeksuar me koeficientët përkatës sipas viteve.

9. Instituti i Sigurimeve Shoqërore nxjerr rregullore të veçantë për llogaritjen dhe procedurën e indeksimit të bazës së vlerësuar për efekt të përfitimeve.

VIII. SHUMA BAZË E PËRFTITIMEVE

1. Shuma bazë e përfitimit nga skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror, kur e drejta ka lindur deri në datën 31.12.2014, të jetë 12 264 (dymbëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë në muaj, kur përfituesi plotëson kushtet, si më poshtë:

a) për pension pleqërie, të ketë plotësuar më shumë se 17 vjet e gjashtë muaj si vjetërsi pune, në marrëdhënie me ish-ndërmarrjet ose institucionet shtetërore, apo si persona të siguruar pas vitit 1994;

b) për pension invaliditeti, të ketë plotësuar më shumë se gjysmën e periudhës minimale të sigurimit, të përcaktuar për këtë lloj pensioni, në marrëdhënie pune me ish-ndërmarrjet ose institucionet shtetërore, apo si persona të siguruar pas vitit 1994;

c) për nënën që ka lindur 6 e më shumë fëmijë, të cilët janë rritur mbi moshën 8 vjeç, të ketë plotësuar më shumë se 30 vite si vjetërsi pune në marrëdhënie me ish-ndërmarrjet ose institucionet shtetërore, apo si person i siguruar pas vitit 1994.

2. Shuma bazë e përfitimit të jetë 8 398 (tetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë në muaj, për

personat që e drejta e përfitimeve u ka lindur deri në datën 31.12.2014, por që nuk e kanë plotësuar vjetërsinë e punës dhe periudhën e sigurimit, sipas përcaktimeve në pikën 1, të këtij kreu.

3. Shuma bazë mujore e pensionit të parakobshëm për vjetërsi shërbimi për personat që plotësojnë kushtet për përfitim sipas dispozitave të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, nga data 1.4.2020 e në vazhdim përcaktohet në vendimet e Këshillit të Ministrave për indeksimin e pensioneve, bazuar në ndryshimin e indeksit të çmimeve të shportës së pensionistëve.

Përfituesit e pensionit të parakobshëm kanë të drejtën e kompensimit të çmimeve sipas masës dhe kriterëve të përcaktuara në vendimin nr. 138, datë 31.3.1994, të Këshillit të Ministrave, "Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse".

Përfituesit e pensionit të parakobshëm minimal kanë të drejtën edhe të kompensimit të të ardhurave, sipas masës dhe kriterëve të përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave, nr. 471, datë 15.7.1996, "Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm"; nr. 401, datë 21.6.2006, "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve"; nr. 763, datë 27.12.2006, "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve"; nr. 415, datë 27.4.2009, "Për rritjen e pensioneve", dhe nr. 477, datë 30.6.2010, "Për rritjen e pensioneve", me kusht që shuma e pensionit mujor plus kompensimin e të ardhurave të jetë shuma sipas periudhave, e përcaktuar në vendimet e Këshillit të Ministrave për indeksimin e pensioneve, bazuar në ndryshimin e indeksit të çmimeve të shportës së pensionistëve.

Në rastet kur pensioni për vjetërsi shërbimi rezulton më i lartë se pensioni bazë dhe, bashkë me kompensimet e të ardhurave, rezulton më i lartë se shuma e të ardhurave minimale prej 14 086 (katërmbeëdhjetë mijë e tetëdhjetë e gjashtë) lekësh, kompensimet jepen pjesore, deri në plotësimin e kësaj shume.

4. Shuma bazë e pensionit, për personat që plotësojnë periudhën e sigurimit, sipas përcaktimeve në nenin 92 të ligjit, kur e drejta për përfitim lind nga data 1.4.2020 e në vazhdim, përfshi edhe këtë datë, të jetë 7 637 (shtatë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë lekë).

Për llogaritjen e pensionit individual, shuma bazë, e përcaktuar si më lart, shumëzohet me vitet dhe muajt e sigurimit, që personi ka arritur nëpërmjet derdhjes së kontributeve dhe pjesëtohet me vitet dhe muajt e sigurimit, të përcaktuara në nenin 92, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar, që i referohet vitit të lindjes të së drejtës për pension. Kur periudha e sigurimit, që personi ka arritur nëpërmjet derdhjes së kontributeve, rezulton edhe në ditë, ditët konvertohen në muaj, sipas rregullit që, 1 muaj ka 30 ditë.

Për vitet në vazhdim, kur plotësohet periudha e sigurimit sipas përcaktimeve në nenin 92, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, shuma bazë do të jetë e barabartë me masën e pensionit të plotë social të përcaktuar për atë periudhë me vendim të Këshillit të Ministrave për indeksimin e pensioneve, bazuar në ndryshimin e indeksit të çmimeve të shportës së pensionistëve.

5. E ardhura për barrë lindje për gratë të cilat periudhën e sigurimit për efekt të përfitimit të barrë lindjes e kanë kanë si persona të vetëpunësuar në bujqësi ose kanë më shumë se 6 muaj të periudhës së fundit të sigurimit nga data e lindjes së të drejtës për pagesë, si persona të vetëpunësuar në bujqësi, duke filluar nga 1.8.2016 e në vazhdim, të jetë 8 652 (tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy) lekë në muaj.

6. Personat e vetëpunësuar në bujqësi janë të detyruar të paguajnë kontribute deri në plotësimin e moshës për pension, sipas nenit 92, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar. Përfshihen nga përfitimi i pensionit të reduktuar personat që në periudhën e përgjithshme të sigurimit kanë edhe vite të siguruara si persona të vetëpunësuar në bujqësi, nga viti 1994 e deri në mbushjen e moshës për përfitimin e pensionit, për aq kohë sa vazhdojnë të kenë kushtet për t'u siguruar si të vetëpunësuar në bujqësi sipas këtij vendimi.

7. Për zbatim të paragrafit të dytë të shkronjës "a", të nenit 5, të ligjit nr. 7514, datë 30.9.1991, "Për pajfjesinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë", të ndryshuar, pensioni mesatar është sa 1,5-

fishi i pensionit bazë të përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi. Kur personi që përfiton nga neni 1, i ligjit të sipërsëhënuar nuk plotëson periudhën e sigurimit sipas përcaktimeve në nenin 92, të ligjit nr. 7703, datë 1.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, mund të zgjedhë të marrë pension të pjesshëm mesatar, shuma e të cilit përlllogaritet duke shumëzuar pensionin mesatar me raportin midis periudhës faktike të sigurimit me periudhën e përcaktuar në nenin 92, të ligjit nr. 7703, datë 1.5.1993, për vitin përkatës.

8. Në zbatim të pikës 3, të nenit 32, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar, shtesa mbi shumën bazë të pensionit të pleqërisë, e llogaritur sipas pikës 2, të këtij neni, është e barabartë me 1 për qind për vit sigurimi shumëzuar me bazën mesatare të vlerësuar mujore, e llogaritur sipas nenit 59 të ligjit. Nëse periudha e përgjithshme e sigurimit të personit nuk është me vite të plota por edhe me muaj dhe ditë sigurimi, për efekt llogaritjesh, numri i ditëve faktike, që rezultojnë mbi numrin e viteve të plota, do të konvertohen në vit duke e pjesëtuar numrin e këtyre ditëve me 365. Në të njëjtën mënyrë përlllogariten edhe shtesat mbi shumën bazë në llojet e tjera të pensionit.

Në rastet kur paga mujore mbi të cilën paguhen kontributet dhe kontributet janë llogaritur dhe paguar mbi një shumë më të vogël se paga minimale ose kontributi minimal i miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave për vitin përkatës, periudha mujore e sigurimit llogaritet duke vënë në raport pagën ose kontributin e paguar me pagën ose kontributin minimal të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, e shumëzuar me 30 (tridhjetë).

Nga ky rregull bëjnë përjashtim muajt me pagesë kontributesh jo të plotë, për shkak se personi ka filluar punë ose është larguar nga puna gjatë muajit. Në këtë rast, për efekt të periudhës së sigurimit merren ditët e punuara.

9. Për përlllogaritjen e bazës së vlerësuar për efekt përfitimi nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe për përfitime nga sistemi i sigurimeve shëndetësore njihet edhe shuma e kontributeve të derdhura për llogari të personit në zbatim të një vendimi gjyqësor, pavarësisht se detyrimi i subjektit punëdhënës mund të jetë më i madh dhe përmban edhe detyrime ende të papaguara për të punësuar të tjerë. Procedurat e derdhjes dhe dokumentimit në bazat e të dhënave përcaktohen me udhëzime të ministrit të Financave.

IX. PAGESA E PËRFITIMEVE

1. Përfitimet afatshkurtra për sëmundje, barrë lindje dhe aksidente në punë e sëmundje profesionale, në favor të të punësuarit, llogariten nga punëdhënësi, ndërsa, për personat fizikë, nga strukturat lokale të sigurimeve shoqërore. Fondet për mbulimin e këtyre pagesave transferohen nga llogaritë e sigurimeve shoqërore në llogarinë individuale të përfituesit, pranë bankave të nivelit të dytë, një herë në muaj, pas miratimit nga organet e sigurimeve shoqërore të listëpagesës. Procedura e kontrollit të listëpagesave dhe e miratimit të llogaritjeve përcaktohet me rregullore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

2. Përfitimet mujore afatgjata u paguhen përfituesve nëpërmjet “Postës Shqiptare”, sh.a., subjekteve financiare profesionale, të pajisura me dokumentet përkatëse nga Banka e Shqipërisë dhe bankave të nivelit të dytë. Subjektet, që do të kryejnë shërbimin e pagesave, caktohen nga Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Rregullat dhe procedurat e pagesës përcaktohen me marrëveshje ndërmjet palëve.

X. BASHKËPUNIMI NDËRMJET INSTI-TUCIONEVE

1. Marrëdhëniet administrative e financiare, ndërmjet Ministrisë së Financave, Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministrisë së Shëndetësisë, Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Bankës së Shqipërisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, bankave të nivelit të dytë dhe “Postës Shqiptare”, sh.a., rregullohen me akte nënligjore dhe me marrëveshje të përbashkëta.

2. Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor kontrollon edhe dokumentacionin që vërteton pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore nga personat e punësuar dhe të vetëpunësuar në veprimtari transporti. Kjo drejtori nuk do të ofrojë asnjë shërbim nëse drejtuesit e mjeteve nuk kanë shlyer detyrimet për sigurimet shoqërore dhe ato tatimore.

3. Subjektet juridike e fizike, që punësojnë invalidë, janë të detyruar të zbatojnë këshillat mjekësore lidhur me punën dhe zgjatjen e orarit të saj, të përcaktuara në vendimet e Komisioneve Mjekësore të Caktimit të Aftësisë për Punë, si dhe të njoftojnë zyrtarisht organet e sigurimeve shoqërore për plotësimin e kushteve të punës të invalidëve, pagën, si dhe për ndryshimin e tyre gjatë periudhës që i siguruari përfiton

trajtim financiar si invalid. Procedurat dhe dokumentacioni përcaktohen me rregullore të ISSH-së.

XI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Personave, që kanë plotësuar moshën për pension pleqërie, sipas përcaktimeve në nenin 31, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, por që, deri më 31.12.2014 nuk plotësojnë periudhën e sigurimit, sipas përcaktimeve në nenin 92, dhe, ndërkohë, vazhdojnë sigurimin e detyrueshëm, pensioni do t’u llogaritet sipas dispozitave ligjore në fuqi, në momentin e ndërprerjes së sigurimit të detyrueshëm.

2. Personave, që kanë plotësuar kriteret për përfitimin e pensionit të plotë përpara datës 31.12.2014 dhe, ndërkohë, vazhdojnë sigurimin e detyrueshëm, pensioni do t’u llogaritet sipas dispozitave në fuqi, në momentin e plotësimit të kushteve për pension, ndërsa shtesa mbi pension, për shtyrjen e datës së daljes në pension, apo të ndërprerjes së tij, dhe rimarrjes në një datë të mëvonshme, sipas nenit 33, të ligjit, do të llogaritet sipas dispozitës në fuqi në vitin përkatës.

2/1. Në mbështetje të paragrafit të fundit, të nenit 6, dhe të paragrafit të dytë të nenit 98, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar:

Personat që përfitojnë pension invaliditeti të pjesshëm kanë të drejtë ta marrin pensionin e invaliditetit edhe kur janë të punësuar ose të vetëpunësuar. Këta persona, kur punojnë si të punësuar apo të vetëpunësuar në sektorin privat, e marrin pensionin mujor të caktuar, pavarësisht nga shuma e të ardhurave mujore që realizojnë nga punësimi apo vetëpunësimi. Ndërprerja e përfitimit të kësteve mujore të pensionit të invaliditetit përcaktohet vetëm me vendim të arsyetuar të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, pas shqyrtimit të gjendjes aktuale shëndetësore të invalidit, zbatimit prej tij të këshillave mjekësore të përcaktuara lidhur me punën dhe kohëzgjatjen e saj, aftësisë për të kryer punë të përshtatshme në varësi të gjendjes shëndetësore dhe respektimit të kriterëve ligjore të përfitimit, të përcaktuara në ligjin nr. 7703, datë 1.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Vendimet nr.1114, datë 30.7.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nr.9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr.10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shfuqizohen.

4. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të nxjerrin udhëzimet e nevojshme, në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.1.2015.

KRYEMINISTRI
Edi Rama